



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 428/3 Prot

Tiranë, më 03/03/2021

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” i ndryshuar me Urdhërin nr. 107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.640 prot, datë 25.02.2021 “Njoftim për vend të lirë punë(pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele)” të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, protokolluar pranë AKPA-s me nr.429/2 prot, datë 26.02.2021, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 05.03.2021, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- 1 mësimdhënës të teorisë profesionaleme kohë të pjesshme në drejtimin Teknologji-Ushqimore me 12 orë/javë.

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2.Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë,

a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacioni.

3. Dokumentet e aplikimit

a) letër motivimi për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;

e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë original ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, brenda datës 25.03.2021.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

